



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1565/6 Prot.

Tiranë, më 26.12.2017

**V E N D I M**

**Nr.239, datë 26.12.2017**

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme së Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të procedurës së verifikimit,

**VËREJ SE :**

Punonjësi \*\*\*\*\*, ka filluar marrëdhënien e punës me aktin administrativ nr. 1573, datë 21.02.2014, të Ministrit të Mjedisit, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë Drejtorinë Rajonale Mjedisore Vlorë. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e gjeti këtë punonjës në këtë pozicion pune për një periudhë më pak se një vit, prandaj bazuar në nenin 67, të ligjit në fjalë, me aktin nr. 3301/250, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, ky punonjës ka përfituar statusin e nëpunësit civil dhe të gjitha të drejtat që garantohen nga ligji për nëpunësin civil.

Me anën e një kërkesë, me nr. 1565 prot., datë 30.08.2017, drejtuar Komisionerit, ky nëpunës pretendon se, për shkak të një mosmarrëveshje me titullarin e institucionit, Drejtoria Rajonale Mjedisore Vlorë, që në këtë rast është dhe eprori i tij direkt, ka lindur një debat midis tyre, i cili ka përshkallëzuar në konflikt fizik. Ky konflikt është transmetuar dhe në media (kronika në linkun: <http://shekulli.info/kryeinspektori-godet-grushte-vartesis-ne-mes-te-rruges-video/>).

Duke qenë se kjo ngjarje është filmuar dhe video është paraqitur në portale të ndryshme mediatike, pamjet i ka administruar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me aktin nr. 1345, datë 23.08.2017, ka urdhëruar ndalimin e subjektit që goditi punonjësin në fjalë, për veprën penale “Goditja për shkak të detyrës”.

Më tej, bazuar në këtë konflikt fizik, ndaj nëpunësin \*\*\*\*\*, eprori i tij direkt ka nisur një ecuri disiplinore, e cila ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, marrë nga Komisioni Disiplinor i ngritur për të shqyrtuar këtë rast.

Në këto kushte, për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, me aktin nr. 1565/3/2, datë 13.09.2017, “*Njoftim mbi fillimin e verifikimit*”, kërkoi nga institucioni, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, të gjithë dokumentacionin që materializon këtë proces disiplinor. Më tej, për të krijuar një konkluzion sa më të saktë në lidhje me këtë rast, duke qenë se në vendimin përfundimtar për dhënien e masës disiplinore, përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike votoi kundër, me shkresën nr. 1565/4, datë 13.09.2017, “*Njoftim mbi fillimin e verifikimit*”, nga ana e Komisionerit, u kërkua qëndrimi me shkrim i njësisë përgjegjëse DAP, në lidhje me rastin në fjalë.

Nga hetimi administrativ rezultoi se vënia në lëvizje e Komisionit Disiplinor, i cili është ngritur me urdhrin nr. 268, datë 16.08.2017, të Kryeinspektorit, ka filluar me kërkesë të titullarit të Drejtorisë Rajonale Mjedisore Vlorë, me nr. 541 prot., datë 15.08.2017.

Njëkohësisht me fillimin e ecurisë disiplinore, me urdhrin nr. 266 prot., datë 14.08.2017, të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, nëpunësi \*\*\*\*\* është pezulluar nga detyra.

Pas shqyrtimit të kërkesës për fillimin e ecurisë disiplinore, Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, me aktin nr. 3834, datë 14.08.2017, i cili njëkohësisht është dhe akti për fillimin e procedimit disiplinor, ka njoftuar nëpunësin \*\*\*\*\* se ndaj tij ka filluar një procedim disiplinor.

Seanca disiplinore për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj nëpunësit në fjalë, është mbajtur në datën 28.08.2017 (*pas një shtyrje*), në ambientet e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Nga analiza e dokumentacionit të administruar rezulton se, gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi ligjor i nëpunësit që i atribuohet shkelja, është ankuar lidhur me mos vënien në dispozicion të asnjë dokumentacioni nga organi disiplinor, për të provuar shkeljen që pretendohet se ka kryer nëpunësi në fjalë (*sipas përmbajtjes të procesverbalit të datës 28.08.2017, të sekretariatit teknik që asiston organin disiplinor*).

Në përfundim, Komisioni Disiplinor, me katër vota pro dhe 1 kundër (*pasi përfaqësuesi i DAP votoi kundër*), me vendimin nr. 5, datë 28.08.2017, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësin \*\*\*\*\*. Në mbështetje të këtij vendimi, me aktin nr. 4101, datë 04.09.2017, “*Për lirim punonjësi*”, Kryeinspektori ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës me institucionin për nëpunësin në fjalë.

Sa më sipër, nga analiza e akteve që materializojnë këtë procedurë disiplinore, rezultojnë disa parregullsi, të cilat cenojnë në thelb gjithë ecurinë disiplinore, duke e bërë këtë proces absolutisht të pavlefshëm, për arsytet që do të parashtrihen në vijim. Gjithashtu, konstatojmë se në këtë ecuri disiplinore ka tendenca subjektivizmi nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, si në cilësinë e titullarit të institucionit, ashtu edhe në cilësinë e kryetarit të organit disiplinor. Këto konstatime i mbështesim me faktet e evidentuara në vijim:

**Së pari.** Konstatohet se me aktin administrativ nr. 266, datë 14.08.2017, “Për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil”, të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, është pezulluar nga ushtrimi i detyrës nëpunësi \*\*\*\*\*, për arsye se ndaj këtij të fundit ka filluar një ecuri disiplinore.

Në pikën 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunës civil”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ, apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”.

Pra, sipas dispozitës që citohet më lartë, është Komisioni Disiplinor organi disiplinor që ka në kompetencë të vendosi mbi pezullimin nga detyra, masë e cila duhet të jepet në rast se ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij dhe jo, kur ndaj një nëpunësi thjesht ka filluar një ecuri disiplinore.

Në këndvështrim të germës “a”, të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunës civil”, i ndryshuar, masa e pezullimit nga shërbimi civil, mbasi vendoset nga Komisioni Disiplinor, konstatohet nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, ku nëpunësi i proceduar ushtron detyrën, ç’ka nuk ka ndodhur në rastin konkret.

Nga sa parashtruam më sipër, arrijmë në përfundimin se, akti nr. 266, datë 14.08.2017, “Për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil”, i Kryeinspektorit, për pezullimin nga detyra të nëpunësit \*\*\*\*\*, është nxjerrë në kundërshtim të hapur dhe flagrant në lidhje me kompetencën. Në këto rrethana, bazuar në germën a/i, të nenit 108, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe bazuar në nenin 110, të ligjit në fjalë, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë, duke u konsideruar sikur nuk ekziston.

**Së dyti.** Njoftimi i nëpunësi \*\*\*\*\* për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tij, është protokolluar me aktin nr. 3835, në datën 14.08.2017 dhe po në të njëjtën datë, është protokolluar dhe urdhri i Kryeinspektorit për pezullimin nga detyra e nëpunësit në fjalë, ndërkohë që akti nr. 541, “Memo”, i titullarit të Drejtorisë Rajonale Mjedisore Vlorë, që ka vënë në lëvizje fillimin e kësaj ecurie disiplinore, është protokolluar në këtë drejtori rajonale në datën 15.08.2017, ndërsa në Inspektoratin qendror në Tiranë, institucioni në të cilin ndodhet Komisioni Disiplinor, është protokolluar me nr. 3877, në datën 21.08.2017.

Pra, nisur nga kronologjia e daljes së akteve si më sipër rezulton se, ecuria disiplinore ka nisur nga Kryeinspektori 7 ditë para se eprori direkt i nëpunësit të proceduar të kërkonte fillimin e një ecurie disiplinore ndaj vartësit të tij.

Gjithashtu, kjo ecuri disiplinore ka nisur nga Kryeinspektori, duke mos u konsultuar me organin disiplinor, që në këtë rast është Komisioni Disiplinor, i cili bazuar në pikën 5, të Kreut I, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e

*procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, funksionon sipas ligjit për organet kolegjiale. Ky konstatim provohet me faktin se, njoftimi për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, është protokolluar në datën 14.08.2017, dy ditë para se të krijohej komisioni disiplinor, i cili është ngritur me aktin nr. 3854, në datën 16.08.2017, të Kryeinspektorit.

Nga sa analizuam më sipër, arrijmë në konkluzionin se, veprimet administrative të Kryeinspektorit për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pezullimin nga detyra të nëpunësit të proceduar, kanë qenë të nxituara dhe subjektive, të cilat vijnë në kundërshtim të plotë me nenet 13 “*Forma e votimit*”, 14 “*Shumica e nevojshme për të marrë vendime*” dhe 15 “*Barazia e votave*”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “*Për funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publike*”.

**Së treti.** Në përmbajtjen e aktit të njoftimit për fillimin e ecurisë disiplinore nuk është përcaktuar veprimi konkret, që pretendohet se ka kryer nëpunësi i proceduar.

Gjithashtu, nuk është përcaktuar masa disiplinore e zbatueshme në këtë rast (*nëse është shkelje disiplinore e lehtë, e rëndë ose shumë e rëndë*) duke u bazuar në shkallën e fajësisë dhe shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, në përputhje me parimin për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore sipas përcaktimeve të nenit 60, të ligjit nr. 152/2015, “*Për Nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Bazuar në pikën 7, të nenit 59, të ligjit të mësipërm, gjatë një procedimi administrativ disiplinor, organi disiplinor ka detyrimin të garantojë të drejtën që nëpunësi ka për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe t’i paraqes provat për kryerjen e saj.

Edhe pse nëpunësi \*\*\*\*\*, në mënyrë të përsëritur, përpara datës së seancës dëgjimore, me shkresat nr. 3894, datë 23.08.2017 dhe nr. 3941, datë 24.08.2017, ka kërkuar të njihet me shkeljen që pretendohet se ka kryer dhe me provat që e mbështesin atë, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për tu mbrojtur, organi disiplinor nuk ka zbatuar detyrimin e tij, duke mos respektuar të drejtat e nëpunësit të proceduar, në kundërshtim të hapur me Kreun X “*Disiplina në shërbimin civil*”, të ligjit për shërbimin civil, Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenin 87 “*Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar*”, të ligjit nr. 44/20151, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

**Së katërti.** Nga përmbajtja e vendimit përfundimtar, rezulton se organi disiplinor, pretendon se nëpunësi \*\*\*\*\*, ka konsumuar këto shkelje, citojmë: “*nuk ka respektuar në mënyrë të përsëritur afatet e caktuara për inspektimet mjedisore, gjë e cila cilësohet si shkelje shumë e rëndë dhe ka sjellë pengesë të procesit të punës në sektorin e mjedisit pranë Inspektoratit Shtetërorë të Mjedisit dhe Pyjeve, dega Rajonale Vlorë; nuk ka zbatuar urdhrin e eprorit në ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit mjedisor; dhe, ka thyerje të Kodit të Etikës*”.

Por, nga ana tjetër, për të gjitha këto pretendime, ashtu si dhe në aktin e njoftimit (nr. 3834, datë 14.08.2017), organi disiplinor nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur ato.

Edhe gjatë seancës dëgjimore, nëpunësit \*\*\*\*\* dhe përfaqësuesit të tij ligjor nuk i është paraqitur asnjë provë nga organi disiplinor. Në kushtet kur, përfaqësuesi ligjor i nëpunësit në fjalë ka kërkuar të njihet me provat që mbështesin pretendimet e komisionit, Komisioni Disiplinor ka marrë vendimin përfundimtar, bazuar vetëm në pretendime.

Nga sa analizuam më sipër, arrijmë në konkluzionin se, vendimi nr. 5, datë 28.08.2017, i Komisionit Disiplinor, për dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , nuk ka dalë si rezultat i një hetimi administrativ, por është mbështetur në bazë pretendimesh.

Këtë konkluzion ka arritur dhe Departamenti i Administratës Publike, në përgjigjen e kthyer pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (nr. 5531/1, datë 09.10.2017), në lidhje me qëndrimin e kundërt të anëtarit të Komisionit, nga radhët e njësisë përgjegjëse.

Më konkretisht, Departamenti ka sqaruar se: “*Komisioni Disiplinor nuk zhvilloi hetim administrativ dhe nuk vlerësoi të gjitha rrethanat e ngjarjes të nevojshme për marrjen e vendimit, në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative; Drejtori Rajonal i ISHMP Vlorë, në cilësinë e eprorit direkt, me nismën e të cilit u zhvillua procedimi disiplinor, nuk ka paraqitur prova për shkëljen e pretenduar; Përfaqësuesi ligjor i \*\*\*\*\* kërkoi shtyrje të seancës, bazuar në kërkesën drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, për t’u njohur me provat e administruara, por nuk u pranua nga shumica e anëtarëve të Komisionit; masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” është marrë në kundërshtim me parimet e objektivitetit dhe përshkallëzimit parashikuar përkatësisht në nenin 14, të Kodit të Procedurave Administrative dhe në nenin 60, të ligjit nr. 152/2015, “*Për Nëpunësin civil*”, i ndryshuar”.*

Nisur nga gjithë analiza e parashtruar më sipër, vendimi nr. 5, datë 28.08.2017, i organit disiplinor, vlerësohet si parregullsi në administrimin e shërbimit civil, pasi vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me legjislacionin e shërbimit civil dhe Kodin e Procedurave Administrative lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij dhe bazuar në germën “*a/ii*”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/20151, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Bazuar në nenin 110, të ligjit në fjalë, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë duke u konsideruar sikur nuk ekziston.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”; e nenin 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të konstatojë

menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 266, datë 14.08.2016, për dhënien e masës së pezullimit për nëpunësin \*\*\*\*\*.

2. Të kërkoj nga Komisioni Disiplinor, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 5, datë 28.08.2016, për dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësin \*\*\*\*\*.
3. Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin e ndërprerjes së marrëdhënies financiare, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të rregullojë pasojat, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 278, datë 04.09.2017, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe të rikthejë punonjësin në pozicionin e mëparshëm të punës.
4. Departamenti i Administratës Publike, të fshijë nga dosja e personelit dhe regjistri Qendror i Personelit, masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, të dhënë ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , me Vendimin nr. 5, datë 28.08.2017, të Komisionit Disiplinor, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Komisioni Disiplinor pranë këtij inspektorati, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative të sipërshënuara, lihet afat, **10** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
7. Me kalimin e këtij afati, institucioni, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**